

# *Komunikimi mes Parlamentit dhe OJQ-ve, kontradiktat e një raporti mes informimit publik dhe marketingut politik*

*Suela Musta\**

## **Abstrakt**

Një nga dilemat e transparencës mes publikut dhe Parlamentit është pikërisht raporti i komunikimit mes Parlamentit, si institucioni më përfaqësues politik i publikut (sovrani) dhe shoqërisë civile, organizatave joqeveritare (që pretendojnë se përfaqësojnë interesat e publikut). Në komunikimin parlamentar, marrëdhëniet me OJQ-të janë një eksperiencë relativisht e re (pas viteve 2000), e cila ka ardhur duke u përafuar me cilësitë e eksperiencave ndërkombëtare. Produkti i kësaj marrëdhënieje, më tepër se një proces informimi për publikun, apo dhe transmetimit të problematikës së tij në aforën e Parlamentit, ka ndjekur më së shumti vektorin e “një strategjie mediatizimi”, si pjesë e publicitetit të marrëdhënieve me publikun nga të dy palët. Në këtë trajtesë shkencore, në fokus do të jetë komunikimi Parlament-OJQ në zbërthim të dilemave të informimit të publikut nga njëra anë dhe, rolit të transparencës apo llogaridhënies parlamentare nga ana tjetër, si pjesë e marrëdhënieve publike të vetë institucionit. Opinioni i mediave si aktor kyç në informim, konsiderohet i nevojshëm në vlerësimin e komunikimit Parlament- Shoqëri civile. Në këtë pikëpamje, raporti i komunikimit Parlament-OJQ, vjen si problematikë ende e pazgjidhur në përcaktimin e termave të informimit apo marrëdhënieve me publikun, ku përfshihet dhe marketingu politik, si pjesë e kësaj strategjie.

Tema do të përfshijë trajtimin e të dhënave dokumentare, tregues statistikorë, të integruar, me interpretim dhe cilësime nga përfaqësues të të dyja palëve dhe gazetarëve që mbulojnë aktivitetin parlamentar

---

\* Suela Musta, PhD Candidate, Tiranë. Email: [suela.musta@gmail.com](mailto:suela.musta@gmail.com)

*Komunikimi mes Parlamentit dhe OJQ-ve, kontradiktat e një raporti mes informimit publik dhe marketingut politik*

**Fjalë kyç:** *angazhim qytetar, komunikim parlamentar, transparencë dhe llogaridhënie, e-parliament, e-participation, e-lobing, e-consultation.*

## ***Hyrje***

Komunikimi në mes Parlamentit të Shqipërisë (Kuvendi) dhe shoqërisë civile vjen si një instrument i shtuar në procesin e hapjes me publikun dhe transparencës në vendimmarrje të institucionit me përfaqësues të demokracisë. Ky studim është pjesë e hartimit të tezës së doktoratës nga autorja me temë “Ligjërimi parlamentar në sfidat e digjitalizimit. E-parliament në Shqipëri 2010-2016”

Analiza e strukturës së këtij komunikimi përfshin një spektër të gjerë interpretimesh dhe krahasime të statistikave dhe të dhënave empirike nga aktiviteti parlamentar, qëndrimet e aktorëve si akse të komunikimit, deputetë-organizatat joqeveritare dhe qëndrimet e palëve të treta që mbikëqyrin këtë proces siç janë mediat dhe publiku. Instrumentet e komunikimit Parlament-OJQ, vijnë në transformim periodik pasi digjitalizimi i informacionit dhe ligjërimit ka përfshirë edhe këtë dimension të komunikimit dhe marrëdhënieve publike me institucionin. Në këtë skemë integrohen komunikimi verbal në mbledhjet e komisioneve parlamentare, transkriptimet e diskutimeve që më pas publikohen në botimet parlamentare, editimi i qëndrimeve të deputetëve dhe grupimeve të shoqërisë civile në ueb-in e Parlamentit, automatizimi i ligjeve, interdinamika e komunikimit në linjë në profilet sociale të deputetëve etj. Komunikimi mes Parlamentit dhe OJQ-ve përcakton edhe standardet e një parlamenti demokratik sipas raporteve vjetore të Unionit Ndërparlamentar Botëror, ku ato përmbliidhen në modulet e transparencës,

arritshmërisë së informacionit, përgjegjësisë, llogaridhënies dhe efektivitetit në komunikim<sup>ii1</sup>

### ***Hipotezat dhe disa modele teorike mbi komunikimin parlamentar me OJQ-të***

Përmes analizës dhe krahasimit të dhënave cilësore dhe sasiore, si dhe interpretimit të tyre në kontestin e kritereve të një parlamenti demokratik, studimi synon të mbështesë këto qasje hipotetike:

- a- Komunikimi mes shoqërisë civile dhe Kuvendit , është tregues që përcakton në shkallë të konsiderueshme standardet e hapjes dhe transparencës së këtij institucioni me publikun në një demokraci pjesëmarrëse
- b- Aksi i komunikimit parlamentar me OJQ-të orientohet më së shumti, sipas cilësive të marrëdhënieve me publikun dhe marketingut politik të institucionit.
- c- Pasojat fundore të komunikimit mes deputetëve dhe administratës së Parlamentit me OJQ-të, ligjet e miratuara me amendime të OJQ-ve si dhe ngritja e opinionëve pas debatit teknik të ligjeve, janë ende në një nivel të ulët në krahasim me parlamentet e vendeve të BE-së.

### ***Modelet teorike dhe qasjet ligjore mbi komunikimin dypalësh - Shoqëria civile (OJQ) dhe Parlamenti***

Teoritë klasike vlerësojnë se pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen e Legjislativit përcakton nivelin e besueshmërisë ndaj Parlamentit dhe legjitimitetit të tij. Këtë nivel komunikimi e ngrenë marrëdhëniet me shoqërinë civile ku sipas konventave të KE-së dhe OKBE-së, OJQ-të janë

---

<sup>1</sup> David Beetham, *Parliament and democracy in the Twenty-first century, A guide to good practice*, Inter-Parliamentary Union, Geneve, 2006.

identifikuar si ato elemente të shoqërisë civile që luajnë rol të rëndësishëm në artikulumin dhe shprehjen e shqetësimeve të qytetarëve dhe në arritjen e shërbimeve që plotësojnë nevojat e tyre. Në këtë kontekst, ato konsiderohen si aktorë të debatit publik në Parlament për të përcjellë qëndrimet e komuniteteve dhe interesave të grupeve të caktuara. Në Rezolutën e Kuvendit<sup>2</sup> shoqëria civile përbëhet nga tërësia e organizatave jofitimprurëse, grupime qytetarësh që përfaqësohen nëpërmjet sindikatave, organizimeve të biznesit, konsumatorëve, organizatave fetare, etnike, lëvizjeve sociale, mediave, si dhe të gjitha grupet e individëve ose individët që janë aktivë në sferën publike.

Nga ana tjetër e drejta parlamentare për komunikim dhe informim parashikon një sërë mekanizmash ligjorë që garantojnë të paktën de juro detyrimin për shkëmbim informacioni me shoqërinë civile. Korpusi ligjor dhe normativ i brendshëm përfshin që nga Kushtetuta e Shqipërisë, Ligji për të Drejtën e Informimit,<sup>3</sup> Rregullorja e Kuvendit,<sup>4</sup> Rezoluta e Kuvendit për shoqërinë civile e deri te Manuali i pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit të Shqipërisë<sup>5</sup>, dhe akte të tjera normative. Rregullorja e Kuvendit dhe dispozitat e brendshme të komunikimit përmes urdhrave

---

<sup>2</sup> Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për Shoqërinë Civile, miratuar më dt. 24. 12. 2014

<sup>3</sup> Ligj nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Fletorja Zyrtare nr.160, Tiranë, 2014.

<sup>4</sup> Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë aksesuar në web [www.parlament.al](http://www.parlament.al), Neni 35 dhe Neni 43, aksesuar në web [www.parlament.al](http://www.parlament.al), datë 12 shkurt 2017

<sup>5</sup> Manual i pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit të Shqipërisë, vendimi nr. 17/2014, Kuvendi i Shqipërisë, Tiranë, 2014

administrativë, ngrenë mjedisin ligjor të komunikimit parlamentar edhe me shoqërinë civile. Në Rregullore parashikohet se Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të Komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim. Gjatë procesit legjislativ, Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të këtij Neni.

Komunikimet një me një dhe një me shumë midis legjislatorëve individualë dhe votuesve të tyre, të përfshirë në një material shoqëruar mbi komunikimin midis legjislatorëve dhe votuesve janë sigurisht elemente të rëndësishme të komunikimit direkt midis një legjislativi dhe publikut. Kjo mënyrë ndihmon ligjberësit të marrin vendime rreth çështjeve të politikave publike, të sigurojnë mekanizma për zgjidhjen e shqetësimeve të qytetarëve mbi qeverisjen dhe të lejojnë një mjet për shprehjen e opinioneve dhe pikëpamjeve të publikut<sup>6</sup>. Sipas ekspertit të së drejtës parlamentare Sokol Berberi, cilësia dhe drejtësia në vendimmarrjen parlamentare varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga informacioni dhe ekspertiza që marrin ligjvënësit gjatë ushtrimit të mandatit të tyre. Rritja e pjesëmarrjes qytetare në procesin legjislativ, siç rezulton nga

---

<sup>6</sup> Gary W. Copeland and Samuel C. Patterson , *Parliaments in the Modern World: Changing Institutions*, Ann Arbor: University of Michigan Press, 1994.

monitorimet e kryera nga Qendra e Studimeve Parlamentare<sup>7</sup>, krijon mundësinë për një sjellje tjetër të publikut ndaj ligjit. Sipas studiueses së shkencave të komunikimit në politikë në “London School of Economics and Political Science”, Jenny Pearce<sup>8</sup>, kriza në demokracinë përfaqësuese është botërisht e njohur dhe sot teoritë klasike flasin për demokracinë pjesëmarrëse, ku edhe kërkohen thellime të studimeve për pjesëmarrjen në kuptimin më real të publikut. Në këtë kuptim studimi i raportit Parlamentar me OJQ-të merr një rëndësi të veçantë studimore për matjen e të dhënave mbi transparencën dhe hapjen e institucionit me publikun.

Modelet teorike kanë pësuar një evoluim të vazhdueshëm në këtë fushë, nisur edhe nga zhvillimet tejet dinamike të teknologjisë së komunikimit. Sot gjithnjë e më shumë flitet për demokraci pjesëmarrëse online ose e-participation, e-consultation, e-emendation, ku thelbi lidhet me pjesëmarrjen e publikut që ngre aforën e sovranit në wall-in e FB-së, përmes opinioneve online në blogje apo portalet e lajmeve, apo rasti kur shoqëria civile zhvillon lobingjet përmes komunikimit online me deputetët në llogaritë e tyre të rrjeteve sociale. Sipas Kurtz<sup>9</sup>, pjesëmarrja e qytetarëve në procesin legjislativ është e rëndësishme në krijimin e këtij kuptimi të legjitimitetit. Praktika parlamentare britanike ofron modelin e një komunikimi të efektshëm me OJQ-të. Parlamenti britanik është i pari në botë

---

<sup>7</sup> Qendra e Studimeve Parlamentare, Pjesëmarrja e publikut në ligjbërje: procesi i vendimmarrjes në Kuvend dhe pjesëmarrja e publikut në të në Republikën e Shqipërisë Analizë krahasuese ligjore mbi këtë rregullim, rezultatet e monitorimit të kryer në Kuvendin e Shqipërisë, Qershor 2011

<sup>8</sup> Jenny Pearce, Palgrave Macmillan, Participation and democracy in the Twenty-first century, 2010

Marcus J. Kurtz Free Market Democracy and the Chilean and Mexican Countryside, Cambridge University press, 2004

që ka ngritur një praktikë të konsoliduar të lobingjeve me shoqërinë civile si dhe komunikimin online me to. Që në vitin 1996-të deputetët britanikë kishin ueb-in e tyre si instrument për komunikim publik.

Sipas studiuësit Coleman<sup>10</sup>, efektiviteti i komunikimit parlamentar lidhet me mënyrën e transmetimit të tij dhe feedback-ut të njoftimeve. Në asociim me digjitalizimin e komunikimit dhe informimit online në Kuvendin e Shqipërisë, ne mund t'u referohemi këtyre instrumenteve:

a-publikimi online i dokumentacionit në ueb të Kuvendit, si dhe procesi i automatizimit të ligjeve;

b-transkriptimi i seancave publike në ueb, përfshirë edhe tekstet e amendimeve ose qëndrimeve të shoqërisë civile;

c-interaktiviteti i sugjerimeve dhe propozimeve në blogjet e ueb-it dhe të faqes në FB të deputetëve nga përfaqësuesit e shoqërisë civile;

d-publikimi online i rezultateve fundore të pritshme të këtij komunikimi, amendimet, në hartimin e drafteve ligjore ose iniciativat për debate publike-politike.

Ndërkaq, pyetjet që ngrenë ekspertët ndërkombëtarë lidhur me marrëdhëniet e parlamentit dhe OJF-të për të ngritur një partneritet dhe komunikim efektiv ndër të tjera janë. Në cilën fazë të procesit ligjvënës duhet të përfshihen OJQ-të? Në një fazë të hershme, atëherë kur mbahen dëgjimet paraprake, apo pas hartimit të Projektligjit? Cila duhet të jetë natyra e kontributeve të autorizuara që mund të japin OJQ-të në procesin legjislativ? A duhet dhënë ky kontribut nëpërmjet dëgjimeve të komisioneve, me mundësinë që kontributi i OJQ-ve të publikohet në shënimet e tyre, apo ky kontribut duhet të

---

<sup>10</sup> Stephen Coleman, Connecting parliament to the public via the internet, two case studies of online consultations, Oxford University, Information, Communication & Society, March 2004

*Komunikimi mes Parlamentit dhe OJQ-ve, kontradiktat e një raporti mes informimit publik dhe marketingut politik*

transmetohet nëpërmjet një serie amendamentesh që duhen mbështetur ligjërisht nga një deputet?

### **3- Transparencë në vendimmarrje apo marketing politik i PR-it të Kuvendit?**

Kontradiktat e këtij Raporti zbërthehen përmes analizës së mëposhtme të të dhënave nga pyetësi me OJQ-të, deputetët dhe stafin e Kuvendit, nisur nga numri i OJQ-ve të regjistruara dhe bilanci i seancave dëgjimore në komisionet respektive, ku rezultojnë se komunikimi parlamentar me OJQ-të në funksion të transparencës dhe llogaridhënies, orientohet sipas aksit të marketingut politik si pjesë e strategjisë së marrëdhënive me publikun të institucionit të Parlamentit.

Regjistri elektronik i OJQ-ve i atashuar pranë Kuvendit për shoqërinë civile regjistron 2744 organizata . Sipas vlerësimeve të zyrës së Tacso- Albania<sup>11</sup>, numri total i OJQ-ve aktive në Shqipëri nuk e kalon 450-shin. Në pyetësor janë kontaktuar 48 OJQ, të cilat kanë bashkëpunuar me Kuvendin gjatë viteve 2013, 2014, 2015. 35 prej tyre thanë që Parlamenti është i hapur deri diku me shoqërinë civile, 13 thanë -jo nuk është i hapur.

*3.1 - Tiparet sasiore dhe cilësore të komunikimit parlamentar me shoqërinë civile*

Sipas të dhënave të mbledhura nga Pyetësi me OJQ-të dhe nga stafet e komisioneve parlamentare rezultojnë se komunikimi përmes e-mail-it të teksteve të amendimeve vjen i dyti në radhën e instrumenteve. Përfaqësuesit e OJQ-ve sa herë që janë ftuar në Komision janë ftuar t'i përcjellin tekstet e amendimeve dhe vërejtjeve për Draftin ligjor përmes e-mail-it dhe shkresave, (memove) Në tipologjinë e komunikimit mes Parlamentit dhe

---


<sup>11</sup> Raport i vlerësimit të nevojave të Asistenca teknike për OJQ-të e Shqipërisë, IPA- Tacso, Tiranë, Tetor 2011



shoqërisë civile , instrumentet që përdoren janë 60 % verbal- 30 % e-mail dhe 10 me korrespondencë.

- 1- Komunikim verbal. ( dëgjesa - Hearing)
- 2- E-mail
- 3- Korrespondencë shkresore, pra komunikim përmes memo-print-it

Komunikimi verbal	60
Komunikimi me e-mail	30
Komunikimi shkresor	10



Të dhëna krahasuese duke iu referuar:

- 1- seancave në komisione parlamentare me numrin e konsultave të OJQ-ve
- 2- numrin e konsiderueshëm por fiktiv të OJQ-ve pranë komisioneve

Bilanci i aktivitetit parlamentar	Viti 2015	Viti 2014
Ligje të miratuara	155	184
Seanca dëgjimore	67	21


Janë marrë në shqyrtim seancat dëgjimore të 8 komisioneve të përhershme parlamentare nga sa dhe bashkëngjitur numri i OJQ-ve, sipas çdo komisioni. Në vitin 2013-të rezultojnë më shumë kontakte me OJQ-të. Kuvendi ka miratuar (185 ligje), ku ka pasur 225 takime me grupet e interesit të ftuar në shqyrtimin e akteve të ndryshme në komisionet parlamentare

Kështu, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me 48 takime, Komisioni i Veprimtarive Prodhuese me 47 takime, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me 35 takime, etj.

Tabela 1 –Raporti i seancave dëgjimore në komisione, krahasuar me numrin e OJQ-ve bashkëngjitur çdo komisioni parlamentar, viti 2015-të


Komisionet e përhershme parlamentare	Viti 2015	
	OJQ-të e atashuara pranë Komisionit	Seanca dëgjimore
Komisioni për Politikën e Jashtme	21	1
Komisioni për Ekonominë dhe Financat	80	3
Komisioni për Sigurinë Kombëtare	18	5
Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin	458	13
Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë	974	15
Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik	688	10
Komisioni për Integrimin Evropian	434	1
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut	71	9

Fig 2- Raporti midis OJQ-ve të atashuara pranë komisioneve parlamentare dhe seancave dëgjimore




Raporti i vlerësimit mbi Transparencën dhe hapjen e Parlamentit nga OJQ-të		Në %
Deri diku i hapur	35	72.9
Jo i hapur	13	27.1
Total	48	100.0

**Fig. 3- Raporti i Vlerësimit mbi Transparencën dhe Hapjen e Parlamentit nga OJQ-të**




Zhvillimi i teknologjisë në qasjen e publikut ndaj Parlamentit dhe në njohjen e ligjeve		<b>Në %</b>
përmirëson qasjen e publikut	36	75.0
Nuk e përmirëson qasjen e publikut	10	20.8
Pa opinion	2	4.2
Total	48	100.0

Fig. 4 -Raporti i vlerësimit të OJQ-ve mbi ndikimin e teknologjisë në qasjen e publikut ndaj Parlamentit dhe në njohjen e ligjeve



Raporti i vlerësimit të retorikës politike dhe trajtimi teknik i drafteve-ligjeve		Në %
Trajtohen më së shumti politikisht, jo teknikisht	29	60.42
Nuk trajtohen si duhet, as politikisht dhe as teknikisht	10	20.83
Pa opinion	9	18.75
Total	48	100.00

Fig. 5-Raporti i vlerësimit të OJQ-ve mes retorikës politike dhe trajtimit teknik të drafteve ligjeve



Burime për grafikët 1, 2, 3,4 dhe 5 ( përpunimi i të dhënave të pyetësorëve me OJQ-të nga autorja e punimit )

### ***Përfundime dhe sugjerime***

Produkti i komunikimit mes deputetëve dhe administratës së Parlamentit me OJQ-të, nuk është në një raport i barazpeshuar me pritshmërinë dhe qëllimin e misionit të shoqërisë civile . Nga analiza e të dhënave sasiore mes konsultave të OJQ-ve me mbledhjet e komisioneve parlamentare, rezulton se propozimet e OJQ-ve për amendime ligjore, janë të pakonsiderueshme. Seancat hearing nuk gjenerojnë informacione fundore të dobishme për draftet ligjore, ku komunikimi njëkahësh përafrohet me elementet e një strategjie PR-i për rritjen e performancës së Parlamentit. Ky sistem komunikimi është vertikal, pra Kuvendi orienton hapjen ndaj publikut dhe jo horizontal ku mesazhi shpërndahet në mënyrë të njëtrajtshme për të arritur tek një produkt final që është Draftligji me sugjerime dhe ndryshime nga grupet e publikut. Lobingjet online mungojnë në komunikimin parlamentar me OJQ-të.

Amendimet e shoqërisë civile që paraqiten në komisionet respektive nuk janë të publikuara në draftin e ligjit në ueb e parlament.al sublinqet në ueb)

Editimi i amendimeve të OJQ-ve për draftet ligjore në sublinqet e web-it [www.parlament.al](http://www.parlament.al) është i rekomandueshëm të fillojë sa më parë. E njëjta praktikë të zbatohet dhe në faqen e FB-së së parlamentit, e cila duhet të formatohet sipas një design-i dhe përmbajtjeje të aksesueshme nga publiku i gjerë. Nevojitet një Kod komunikimi me instrumente të përcaktuara qartë në marrëdhëniet me shoqërinë civile, me OJQ-të, edhe sipas praktikave të parlamenteve të BE-së.

## ***Bibliografia***

Beetham, David. *Parliament and democracy in the Twenty-first century, A guide to good practice*. Inter-parliamentary Union. Geneve: 2006.

Coleman, Stephen. "Connecting parliament to the public via the internet, two case studies of online consultations". *Information, Communication & Society*, March 2004.

Copeland, Gary W. & Patterson, Samuel C. *Parliaments in the Modern World: Changing Institutions*. University of Michigan Press: 1994.

Ligj nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Fletorja Zyrtare nr.160, Tiranë, 2014.

Marcus J. Kurtz, *Free Market Democracy and the Chilean and Mexican Countryside*. Cambridge University press: 2004.

Manual i pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit të Shqipërisë, vendimi nr. 17/2014. Kuvendi i Shqipërisë. Tiranë. 2014.

Pearce, Jenny. *Participation and democracy in the Twenty-first century*. Palgrave Macmillan: 2010.

*Komunikimi mes Parlamentit dhe OJQ-ve, kontradiktat e një raporti mes informimit publik dhe marketingut politik*

Qendra e Studimeve Parlamentare, Pjesëmarrja e publikut në ligjbërje: procesi i vendimmarrjes në Kuvend dhe pjesëmarrja e publikut në të në Republikën e Shqipërisë Analizë krahasuese ligjore mbi këtë rregullim, rezultatet e monitorimit të kryer në Kuvendin e Shqipërisë, Tiranë, Qershor 2011

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për shoqërinë civile miratuar më dt 24. 12. 2014, Tirane

Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, aksesuar në ueb [www.parlament.al](http://www.parlament.al) , neni 35 dhe Neni 43, aksesuar në ueb [www.parlament.al](http://www.parlament.al), datë 12 shkurt 2017

Raport i vlerësimit të nevojave të Asistenca teknike për OJQ-të e Shqipërisë, IPA- Tacso, Tiranë, Tetor 2011